

Krime Luftë në ish Jugosllavi e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim. Vendimi është i plotfuqishëm.

**Burimet:** deklarata Xh.E, FDH-34656; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int\\_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi(-IT-03-66-);) ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.312.55, FDH-31063; OMPF, *Regjistri i konsoliduar.*, FDH-32367.

## Ibush (Bajram) Hamza

(15.07.1949, shqiptar nga Korrotica e Poshtme/Donja Koretica, komuna e Gillogocit/Glogovac, tre fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar Korroticën e Poshtme/Donja Koretica në muajin qershor të vitit 1998. Kjo e shtyu familjen e Ibushit ta braktiste fshatin. Ai ndenji në shtëpi. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e shihnin të gjallë. Ibushi ka qenë i mbyllur në burgun e UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**. Në datën **25** apo **26.07.1998**, Ibushi dhe nëntë të burgosur të tjerë u pushkatuan në **Malet e Berishës/Berishine planine** [Malishevë/Mališevo]. Mbetjet e tij mortore u zbuluan në varrezën masive në vendin e ekzekutimit. Obduksioni i trupit të Ibushit, i kryer në muajin shtator të vitit 2001, ka konstatuar se vdekja e tij ka rezultuar nga plagët e shumta të shkaktuara nga armë zjarri. Kontrolli shtesë, i bërë nga ekspertët e mjekësisë ligjore, ka konfirmuar se vdekja ka rezultuar nga plagët e shumta në gjoks dhe komblik. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Ibushit në varrezat e Korroticës së Poshtme/Donja Koretica më 3.05.2005. Për vrasjen e Ibushit dhe tetë të burgosurve të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim.

**Burimet:** deklarata R.H, FDH-17994; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int\\_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi(-IT-03-66-);) OMPF, *Mbetjet.*, FDH-15297; OMPF, *Regjistri i konsoliduar.*, FDH-32367.

## Hasan (Halim) Hoxha

(10.03.1946, shqiptar nga Miradija e Ulët/Donje Dobrev, komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, punëtor, gjashtë fëmijë)

Deri në vitin 1990, Hasani ka punuar si punëtor i sigurimit të brendshëm në hotelin *Grand* në Prishtinë/Prishtina. Pastaj merrej me shitblerjen e automobilave dhe të bagëtisë. Ishte simpatizues i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Në datën 17.07.1998, ai u nis me një mik dhe djalin e këtij të fundit për në fshatin Shalë/Sedlare [Lipjan/Lipljan]. Dy muaj më vonë, ky mik u ka treguar familjarëve se ata që të tre ishin arrestuar nga pjesëtarët e UÇK-së në Shalë/Sedlare, nga ku u dërguan në burgun e UÇK-së në **Lapushnik/Lapušnik**. Në datën **25** apo **26. 07.1998**, pjesëtarë të UÇK-së i çuan që të gjithë të burgosurit në **Malet e Berishës/Berishine planine**. E liruan një grup, në mesin e tyre edhe mikun e Hasanit, por Hasanin e ndalën, ndërkaq, më vonë, edhe e pushkatuan. Në muajin prill të vitit 2002, trupi i Hasanit u zbulua jo shumë larg nga vendi i vrasjes. I vëllai Ramadani dhe i biri Nuhiu e identifikuan në bazë të rrobave të trupit. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Hasanit në varrezat e fshatit Vragoli/Vragolija [Fushë Kosovë/Kosovo Polje] më 7.03.2005. Për vrasjen e Hasanit dhe tetë të burgosurve të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim.

**Burimet:** deklarata N.H, FDH-29231; deklarata N.H, FDH-33732; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 15.11.2004, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20Uvodna%20rec%20Tuzilastva%20-%2015.11.2004.pdf>; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 31.03.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20svedoci%20L-64%20i%20A.Kereakes-31.03.2005.pdf>; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 21.03.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20svedok%20L-64%20-%2021.03.2005.pdf>; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int\\_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi\(-IT-03-](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi(-IT-03-)